

edhe sqarimet lidhur me namatisjet kundër sëmundjeve të caktuara. Vërejtjet dhe komentet janë shtruar në një mënyrë të matur dhe të shkathtë, gjë që vërteton se autori i tyre është i informuar mirë mbi literaturën në të cilën diskutohet për këto probleme, veçanërisht kur është fjala për literaturën tonë dhe atë në gjuhën ruse.

Bibliografia vë në dukje burimet dhe studimet e namatisjeve si lloj të krijimeve popullore të të folurit. Ajo ndahet sipas sferave gjuhësore, kështu që së pari jepet literatura dhe burimet në gjuhën serbokroate, pastaj në atë maqedone, sllovene, bullgare, dhe në gjuhën e popujve sllavë të lindjes dhe në fund literatura nga gjuhët joslave. Numri më i madh i një-sive bibliografike është në gjuhën serbokroate (nga numri i përgjithshëm prej 665 sish, në gjuhën serbokroate janë 469). Punimet e cekura në *Bibliografi* ku nuk ka shembuj të namatisjeve Radenković i ka veçuar duke i shënuar me një yll, dhe kështu ka arritur tërësinë e çdo një-sie bibliografike dhe i është shman-gur dhënies së dyfishtë të një numri të madh një-sish bibliografike. Vëllimi i *Bibliografisë* gjithashtu dëshmon mbi informimin e mirë të autorit, si për burimet e namatisjeve në gjuhën serbokroate, ashtu edhe për literaturën që merret me studimin e tyre, jo vetëm te ne, por edhe në botë.

Fjalori i fjalëve më pak të njohura do t'i shërbejë lexuesit për kuptimin

e teksteve ndonjëherë jo mjaft të qarta, që në të vërtetë janë të paqarta për shkak të ndonjë fjale aty-këtu, qoftë ajo krahinore ose e huaj, por e përvetësuar në gjuhën e popullit, ose është e huaj dhe shumë e vjetër, kuptimin e së cilës sot nuk e kupton lexuesi bashkëkohor.

Regjistri përfshin emrat personale, por pranë tyre edhe fjalët, emrat e vlerave të shumta që paraqiten në namatisje. Ai do t'u shërbejë jo vetëm hulumtuesve, por edhe lexuesve kureshtarë në përgjithësi. Me fjalët në *Regjistër* vihet në dukje edhe numri i namatisjeve ku gjendet ajo fjalë, gjë që ka një rëndësi të veçantë.

Në fund të librit janë dhënë rezy-metë në gjuhën angleze dhe ruse, çka gjithashtu plotëson aparatën shkencor.

Thënë shkurtimisht: Ky është një libër i mirë dhe shumë i dobishëm për studimin e mëtejshëm të namatisjeve në gjuhën serbokroate, por edhe shembull se si mund të punohen librat me namatisje edhe në gjuhët e tjera, të cilat, sikur të ishin më shumë, do të kontribuonin në mënyrë konsiderueshme në hulumtimin krahasimtar të këtij lloji të krijimeve popullore të të folurit. Për një rreth të gjerë lexuesish tekstet e namatisjeve do të jenë lekturë interesante dhe do t'i zgjerojnë njohuritë mbi këtë lloj të kulturës së vjetër gojore popullore, por libri edhe si tërësi do të kontribuojë në shikimin e gjerë të trashëgimisë sonë gojore.

VLADIMIR BOVAN

KËNGË DHE LOJËRA TË FËMIJËVE, Instituti Albanologjik i Prishtinës, përgatitur nga Sadri Fetiu, Prishtinë 1983, f. 394.

Letërsia popullore, e cila, pos kënaqësisë shpirtërore, ka luajtur rol të rëndësishëm për edukimin, aftësimin dhe për ngritjen e vetëdijes artistike të shtresave të gjera, ka synuar të plotësojë nevojat e njerëzve të moshave të ndryshme brenda kufijve të mirësjelljes dhe të normave që respektoheshin në jetë. Kjo dëshmon se letërsia popullore gjatë trajtimit të problemeve është thelluar në sferat e ndryshme të jetës dhe të aktiviteteve njerëzore, varësisht nga interesimi

i moshës së brezit të cilit i është kushtuar.

Kufiri që i ndan krijimet e fëmijëve nga ato të të rriturve nuk është shumë rigoroz, ashtu si nuk janë rigorozë as ndarjet ndërmjet llojeve të kësaj poezie. Herë-herë kufiri ndërmjet llojeve të poezisë popullore është aq i njësuar sa vështirë gjenden elementet dominuese të njërit mbi tjetrin. Megjithatë, në bazë të disa elementeve dhe normave të kodifikuara rreth përcaktimit të gjinive dhe të

llojeve letrare, është bërë klasifikimi kryesor i kësaj poezie në lloje e zhanre.

Në bazë të klasifikimeve të tilla që kanë të bëjnë me realizimin e planit afatgjatë hulumtues dhe botues të Institutit Abanologjik të Prishtinës në Degën e Folklorit, vazhdon edhe botimi i blenjeve të letërsisë popullore shqiptare. Bleni X me radhë, *Këngë dhe lojëra të fëmijëve*, doli nga shtypi me një përgatitje dhe klasifikim të denjë nga Sadri Fetiu.

Krijimet poetike popullore të fëmijëve, të cilat kryesisht përfshihen në sferën e poezisë dhe të lojërave kanë rëndësi të veçantë për shumë arsye: për mënyrën e interpretimit pa instrumente muzikore, për moshën e interpretuesit dhe të krijuesit, që, pos shumë kufizimeve të tjera, ka edhe kufizime të veçanta shprehëse gjuhësore.

Poezia e fëmijëve është pjesë e poezisë popullore, por i ka veçoritë e saj dalluese që janë tradicionalisht të theksuara, të cilat i kushtëzon moshë, gjuha, liria, etika, përvoja njohëse e krijuese etj.

Poezia popullore e fëmijëve trajton shumë aspekte të botës së fëmijëve dhe të jetës së tyre në përgjithësi. Prandaj ajo paraqet lojërat e fëmijëve, dëshirat, iniciativat e tyre, paraqet gjendjen shoqërore, ekonomike, vizionin për ardhmëri, luftën e përditshme të njeriut për ekzistencë dhe për jetë të mirë, të lumtur e të pavarur. Shumë nga këto motive i trajton edhe poezia popullore e të rriturve.

Pra, qëllimi dhe porosia e kësaj poezie është të kryejë funksione nëpërmjet humorit ose nëpërmjet lojës naive, por shumë argëtuese. Ambienti i fëmijëve, i kushtëzuar tradicionalisht nga rrethanat jetësore ekonomike dhe kulturalë, është po ai ambient ku jetojnë dhe veprojnë të rriturit. Kjo jep të kuptohet se ata janë të edukuar dhe të detyruar që të punojnë e të verojnë njësoj si të parët e tyre, t'i respektojnë normat e moralit ekzistues. Në kushte dhe rrethana të atilla, poezia popullore e fëmijëve është një shkollë për ardhmërinë, e mbështetur kryesisht në përvojën jetësore dhe në filozofinë e popullit. Në këtë drejtim mund të konstatohet se është ndjekur çdo

shkëndijë pozitive e virtyteve kombëtare nga e kaluara, është kultivuar dhe është provuar si mënyrë e jetës me format e caktuara të arsimimit, edukimit dhe të veprimit.

Poezia popullore e fëmijëve ka mënyrë interesante të komunikimit. Ajo komunikon me një gjuhë, e cila në shumë raste është e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme, por ndonjëherë del edhe e turbullt, e pakuptueshme, enigmatike. Edhe stili i saj, megjithëse shumë më i varfër se ai i poezisë për të rritur, ka dromcat filozofike të urtësisë dhe të përvojës së rryer që është akumuluar gjatë shekujve në traditën popullore.

Nuk mund të mohohet fakti se mbi këtë poezi kanë shkruar një pjesë të talentit të vet edhe të rriturit, qoftë nga dashuria për vetë fëmijët, qoftë për arsye praktike që të komunikojnë më lehtë me të vegjlit. Prandaj, mund të dëshmohet fare lehtë prania e të rriturve dhe kontributi i tyre për kultivimin dhe ruajtjen e këtij lloji të poezisë lirike. Të rriturit, sidomos prindërit dhe pleqtë, në këtë poezi janë paraqitur shpesh edhe si personazhe.

Por në këto këngë e sidomos në lojërat e numërimit ekziston edhe pakuptimësia e vërtetë që mund të shpjegohet në bazë të funksionit të tekstit për lojën dhe argëtimin e fëmijëve e pastaj edhe nga aspektet e jetës, ruajtjes së sekretit, përcjelljes së porosisë në mënyrë të tërthortë, ndikimet e rrethit, pozitën e fëmijës në gjirin e familjes dhe në shoqëri etj.

Në poezinë e fëmijëve ruhen elementet që dëshmojnë lashtësinë e saj, që do të thotë se ajo u krijua dhe u zhvillua, u përcoll dhe bëri jetë të njëjtë me llojet e tjera të poezisë popullore. Elementet e besimit në periudha të ndryshme, respektimi i bimëve dhe i kafshëve në rangun e kultit ose të totemit, kundërthëniet e njeriut me rrethin dhe me dukuritë natyrore, lufta për ekzistencë në bazë të insistimit për rregullimin e kushteve jetësore dhe kapërcimi i vështirësive të ndryshme nëpërmjet forcës magjike, të fuqisë së formula-ve të saj janë pjesë e traditës së kaluar të popullit tonë, e cila është përcjellë gojarisht me qindra vjet.

Ky art i fëmijëve, goftë pjesa letrare, muzikore apo ajo etnografike, lidhet ngushtë me traditën e edukimit të breznive, prandaj ajo shtrihet në shumë sfera të jetës dhe mund ta konsiderojmë se ka fituar njëfarë universaliteti të trajtimit të temave dhe të motiveve, duke kultivuar në këtë pjesë të artit ndjenjat humane, optimizmin, dashurinë për ardhmëri, dashurinë ndaj kolektivitetit dhe, më në fund, e shton dëshirën dhe vullnetin për të luftuar çdo gjë të dëmshme dhe të keqe. Me angazhim të këtyre poezia e fëmijëve ka luajtur rol të rëndësishëm arsimor-edukativ, duke u dhënë edhe ushqim shpirtëror gjeneratave të reja.

Arti i fëmijëve, i përfshirë kryesisht në këngë dhe në lojëra, paraqet një fushë të rëndësishme për studime, duke bërë të mundshme lidhmërinë ndërmjet artit fort të lashtë të popullit dhe vazhdimin e traditës kulturore e krijuese artistike të kombit. Fushat e ndryshme të krijimtarisë së fëmijëve: kënga, muzika, lojërat dhe vallet i kanë plotësuar nevojat shpirtërore e kulturore, kanë zgjuar interesimet dhe dëshirat për shije artistike të fëmijët. Në këtë mënyrë ata kanë zhvilluar imagjinatën e tyre, aftësitë psiko-fizike, i kanë shtuar interesimet për gjykime rreth problemeve të ndryshme, dhe kështu kanë krijuar personalitetin e tyre.

Vëllimi *Këngë dhe lojëra të fëmijëve* është përgatitur me kujdes nga Sadri Fetiu. Zgjedhja e materialit, radhitja, redaktimi, sistemimi, shënimet e nevojshme përcjellëse për subjektet dhe mbledhësit e, ndër të tjera, parathënia e shkruar me përkushtim të veçantë shkencor, e bëjnë këtë vepër ndër vëllimet më solide që ka botuar Instituti Albanologjik deri më tani.

Parathënia është edhe një përpjekje serioze për ndriçimin e shumë çështjeve që kanë të bëjnë me artin popullor letrar të fëmijëve. Sadri Fetiu ka shënuar historikun e interesimeve të folkloristëve shqiptarë dhe atyre të huaj, sistemimin që bënë ata, vlerësimin që i bënë kësaj poezie si dhe mendimet rreth nocioneve shkencore dhe praktike që u shfaqen në botime e publikime të ndryshme.

Kuptohet se pjesën më të suksesshme të kësaj përvoje pozitive, sidomos atë që i ka kontribuar në mënyrë të bindshme aspektit të klasifikimit të poezisë popullore të fëmijëve, ai e ka shfrytëzuar në përgatitjen e veprës në fjalë.

Sadri Fetiu është orvatur ta arsyetojë klasifikimin e këtyre dhe të japë sqarime për secilin lloj të poezisë popullore të fëmijëve, duke konsideruar si primare aftësitë psikofizike të këtij brezi, zgjedhjen e temave dhe të motiveve për trajtim, fjalorin, kushtet në të cilat u krijuan këngët, sferat e jetës të cilat fëmijët i njohin më mirë dhe për të cilat kanë interesim më të madh. Madje, ç'është më kryesore, ai ka arsyetuar anën praktike të ndarjes së kësaj poezie në lloje, e cila si praktikë është e domosdoshme, si kusht i parë i çdo parathënie që i prin veprës.

Natyrisht se Sadri Fetiu ka bërë përpjekje ta klasifikojë këtë poezi edhe mbi baza që dëshmojnë lashtësinë e saj. Prej këndeje, kontakti i parë, kënaqësia e parë dhe, poashtu rreziku i parë për njeriun janë konsideruar natyra dhe fenomenet e saj. Prandaj, duke u nisur nga ky aspekt, ai llojin e parë të këngëve e zgjedh, me të drejtë, nga kjo sferë dhe e pagëzon *Këngë për fenomenet e natyrës*.

Për llojin e dytë të kësaj poezie, *Këngë për bimët*, Sadri Fetiu paraqet mendime interesante, të cilat, edhe pse supozime që nuk kapin bindjen me gjerësinë e fakteve, ato hapin shteg të sigurt për konkluzione të drejta shkencore, sidomos arsytimi pse janë të pakta numerikisht dhe mundësia që këto këngë të jenë krijuar nga të rriturit, kurse interpretues besnik kanë mbetur përherë fëmijët.

Në llojin e tretë, *Këngë për insektet*, karakteristikat tematiko-motivore i ka hetuar mirë autori i parathënies, duke vënë në pah se këto këngë janë të shkurtra dhe numerikisht janë të pakta. Kështu si kanë ngehur ato, janë relike të një tradite të lashtë që ka dimensionet e shtrirjes së vet në krijimtarinë e shumë popujve. Disa nga insektet këndohen për t'u nxitur njeriu në ndojnë veprim ose realizim dëshire siç është mollëkuqja, xixëllonja, zekthi, flutura, kur-

se disa krijuesi i vogël i përkëdhel, sepse këtë ia imponon intimiteti, kurreshtia dhe loja me to.

Këngët për shpendët janë lloji që ka shtrirje të gjerë. Edhe te shpendët fëmija sheh rregullimin e raporteve në realitetin jetësor, ndoshta për shkak të besimeve dhe të mendimeve dominuese lidhur me shpendët, ndoshta për shkak të lëvizjeve të tyre të lira e të mrekullueshme, që për aftësitë mendore të fëmijëve paraqesin diçka të pambërrishme, ndoshta edhe për shkak të bukurisë së tyre fizike, ose edhe për shkak të këngës së tyre mbi drunjtë e lartë. Se gjithmonë anohet me simpati kah shpendët, e dëshmon edhe ajo se një mënyrë e lajkave dhe e përkëdheljes ndërmjet njerëzve është t'i pagëzosh me emra shpendësh, t'u drejtohesh për cilësitë e tyre si të shpendëve etj. Pra, për shpendët diçka lakmuese do të ketë ekzistuar, e ekziston edhe sot te fëmijët. Këtë simpati e kanë shfaqur më vonë edhe krijuesit e letërsisë së kultivuar.

Duhet të konstatohet se kjo tematikë i ka tërhequr shumë krijuesit e vegjël dhe kudo i kanë në gojë, pothuaj të gjithë shpendët me të cilët jetojnë në ambient të caktuar. Shpendët, sidomos ata të egrit, për fëmijët janë mrekulli e vërtetë, të pambërritshme në fluturimin e tyre nëpër qiellin e hapët. Prandaj mu për këtë e kanë mbajtur të gjallë interesimin e fëmijëve për to, ata e kanë shpirtëzuar në aktivitete të ndryshme, në lojë, në humor, në gjueti, kinse, në krijimet dramatike që në të vërtetë janë krijime në prozë etj.

Këngët për shpendët, për ambientin e tyre ku sillen e jetojnë, për mundësitë e tyre, që sipas fantazisë së fëmijëve janë të pakufishme, kanë vlera të veçanta artistike. Krijuesi, në këtë lloj poezie, pos apostrofimeve dhe personifikimeve të bukura e kuptimthella, ka përdor edhe figura të bukura që e poetizojnë tërë ambientin, veprimtarinë në të cilën aludohet etj. Çfarë simbolike dhe çfarë profetizimesh mund të merren me mend në këngët që fëmija i këndon për qyqen! Vërtet kjo poezi ka nuanca më të theksuara letraro-artistike.

Në këtë lloj poezie të vegjlit shprehin lirizmin në forma më të gjera,

dhe kështu i japin këngës së tyre vlera të shquara në mesin e llojeve të tjera të lirikës popullore.

Këngët për kafshët, si lloj më vete, janë po ashtu të shumta, shtrihen në të gjitha trevat, por që natyrisht se u këndohet shtazëve që janë të ambientuara aty ku krijohet edhe kënga. Aspekti i trajtimit humoristik të ngjarjeve e ndodhive është i theksuar edhe në këtë lloj të këngëve. Ndoshta diçka më tepër idealizohet puna dhe dashuria ndaj kafshëve. Në këngët humoristike disa nga shtazët bëhen sikur fëmija ose zëvendësojnë plotësisht personazhin real — fëmijën.

Shtazët nuk paraqiten në këngë as të tmerrshme as të rrezikshme. Kjo masë e trajtimit të botës shtazore, si botë e dashur, botë e njerëzuar, është meritë e krijuesit popullor, sepse ai nuk ka krijuar botë të frikës, por të miqësisë dhe të dashurisë së fëmijëve në ambient dhe në atmosferë të hareshme.

Fëmija krijues nuk ka dëshiruar ta njohë, ta ketë afër dhe të këndojë për rrezikun.

Disa nga këngët e këtij lloji, siç ka konstatuar edhe autori i parathënies, këndohen duke u bazuar në melodinë e qartë e të formuar, të artikulluar mbi bazat e muzikologjisë popullore. Këto këngë që i takojnë sferës së aktivitetit baritor janë më të avansuara në pikëpamje artistike.

Këngët e vajzave, ashtu si edhe këngët baritore për kafshët shtëpiake, janë me interes edhe për mënyrën e të kënduarit, për përcjelljen me gisht, do të thotë të vetinstrumentimit, e cila, si përcjellje specifike, u jep vlerë të veçantë muzikore krijimeve të tilla.

Karakteristikë e këtyre këngëve janë hareja dhe optimizmi. Këto këngë këndohen në ambiente të hapura: në fusha e livadhe, në male e kodrina, si edhe në ambiente të mbyllura: në dhoma e lokale të tjera. Këngët e tilla këndohen edhe në gazmende që kanë karakter më të gjerrë shoqëror, me rastin e ndonjë të krenrtje etj.

Disa nga këngët e vajzave i vënë në shpoti raportet ndërmjet njerëzve.

Në llojin e shtatë janë radhitur *Këngët për veprimet e fëmijëve*. Këto këngë, sikurse edhe këngët e tjera të traditës, lidhen ngushtë me be-

simet në fuqinë e poezisë, në forcën magjike të fjalës poetike, e cila kinse i ndihmon veprimet, punët dhe gjestet e caktuara për realizimin e dëshirave të fëmijëve. Këto këngë dhe instrumentimi i tyre u ngjajnë formulave të fallit dhe thuhet në formë rituali.

Humorin e fëmijëve si term, Sadri Fetiu e ka zëvendësuar me fjalën shpoti dhe tërë ciklin e quan *Këngë shpotitëse*. Shpotinë ai e konsideron, me të drejtë, si formë të veçantë të humorit të fëmijëve që nxit të qeshurit, frymëzon për argëtim dhe që ka specifikat e veta, sepse në midisin e këtij brezi të njomë ka qëllime të caktuara, por edhe kufizime të dukshme. Në këto këngë ruhet mjaft masa e sjelljes njerëzore, e respektimit të dinjitetit dhe të personalitetit të çdo individi. Shpotia, pra, është një dozë shëruese — i lufton dobësitë dhe nuk e frynë unën e fëmijës.

Këto këngë kanë për personazhe edhe njerëz të rritur, e kjo do të thotë se e kanë zgjeruar mjaft rrethin shpotitës. Në to hetohet një rrëfim spontan që lidhet ngushtë me realitetin, me dëshirat dhe aspiratat konkrete të brezit të njomë.

Vlerën e *Lojërave të numërimit*, Sadri Fetiu e ka konstatuar me vend. Në këto këngë dominon bukuria tingullore, por më shpesh në këtë drejtim ngel prapa thellësia kuptimore dhe qartësia e fjalëve dhe e vargut, e cila në raste të tilla nuk e arrin poetizimin e plotë të tekstit dhe të figuracionit. Këtu rima dhe roli i saj kanë qëllime më tepër praktike në këto këngë, të cilat, të themi qartë, se më shumë janë të lidhura me procesin etnografik sesa me procesin e krijimit letrar.

Për *Lojërat e vatrës*, në të cilat rol të rëndësishëm luajnë dialogu dhe interpretët, autori i parathënies pohon se në këtë lloj të krijimtarisë popullore të fëmijëve ruhen gjurmët e sigurta të dramës letrare popullore.

Në raportet që krijohen ndërmjet njerëzve dhe qenieve të tjera në këto lojëra, mbetet të dëshmohet për botëkuptimet e lashta që janë transmetuar dhe kanë siguruar ekzistencën në ato krijime popullore, të cilat janë ruajtur deri më sot. Lojërat e vatrës, si tekste, me vetë format e di-

alogut dhe kushtëzimin e veprimeve, largohen nga poezia e mirëfilltë.

Një pjesë e kësaj poezie i trajton ngjarjet nga aspekti humoristik, ku përqeshen dukuritë nga realiteti jetësor dhe karakteret e dobëta të njerëzve.

Në *Lojërat dhe këngët e ndryshme* Sadri Fetiu radhit disa lloje krijimesh poetike të fëmijëve, të cilat ose kanë specifika si lojëra të veçanta ose e kanë të përzier llojin, e në këtë aspekt janë me përkatësi të paqartë, qoftë për nga motivet, qoftë për nga mënyra e interpretimit, ndoshta edhe për nga struktura specifike ritmike që i konvenon lojës. Këto këngë radhiten këtu si mundësi e fundit e krijimeve artistike letrare të fëmijëve, me të cilat, kuptohet nga vetë pagëzimi i tyre, rrumbullakësohet ndarja në lloje brenda këtij bleni.

Sado që poezia popullore e fëmijëve ka një gjuhë dhe një stil që dallohet nga poezia popullore e të rriturve, rëndësia e gjuhës së kësaj poezie ka vlerë në kuadrin e përgjithshëm të gjuhës letrare popullore. Struktura e kësaj poezie shquhet për specifikën e vet tingullore të fjalëve dhe të figurave, shpesh me pikënisje onomatopeike.

Struktura e veçantë tingullore, ritmi karakteristik dhe forma recitative e interpretimit e karakterizojnë tërë poezinë për fëmijë, pos këngëve baritore dhe atyre të vajzave, që interpretohen në bazë të melodisë së mirëfilltë dhe, si të themi, të artikuluar.

Në pajtim me rëndësinë dhe funksionin artistik të kësaj kënge popullore shquhet edhe vlera e saj letrare artistike. Format shprehëse si monologu dhe dialogu tregojnë për përkushtimin e krijuesit, ndërsa apostrofi mi dhe personifikimi janë rrugët kryesore komunikuese, me të cilat fëmijët i zhdukin kufijtë midis dukurive e njerëzve, midis botës bimore e shtazore dhe fenomeneve të natyrës. Nga ky aspekt, humanizimi i botës në poezinë popullore të fëmijëve ka një kuptim të veçantë stilistik dhe filozofik për jetën dhe botën në tërësi. Poashtu, universalja, e madhërishtësia dhe e bukura në këtë poezi

shquhen me nuancat e veta. Gazin fëmijëror nuk e lëndon tragjikja, pikëllimi dhe e shëmtuara. Fëmija krijues në këtë poezi nuk e ka dëshiruar tendencën që do të manifestonte asnjë element, me të cilin do të vështirsohej të jetuarit e njeriut.

Përfundojmë me bindje se vargjet e këngës popullore shqiptare të brezit më të ri, që janë krijuar në të kaluarën dhe sot, ka mjaft dritë optimiste për njerëzit, për jetën dhe për fatin e tyre.

RRUSTEM BERISHA